



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E PROKURORËVE  
KOMISIONI I VOTIMIT

Tiranë, më 25.10.2022

PROCESVERBAL

**I PROCESIT TË VOTIMIT NGA MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E  
PROKURORËVE PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT PROKUROR NË  
KËSHILLIN E LARTË TË PROKURORISË DHE ANËTARIT NË  
KËSHILLIN DREJTUES TË MAGJISTRATURËS**

Sot, më 25.10.2022. ora 12.12, në Tiranë, mbahet ky procesverbal për të dokumentuar votimin nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve për zgjedhjen anëtarit prokuror në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe anëtarit në Këshillin Drejtues të Magjistraturës, në bazë të nenit 115 dhe nenin 247, pika 1, shkronja “d” të Ligjit nr.1 15/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe pikës 2 të Rregullores nr. 3152/5, datë 11.12.2018, “Për procesin e votimit për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit të votimit dhe për procesin e votimit të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve në përputhje me rendin e ditës, votoi për zgjedhjen e 1 (një) prokurori pranë gjykatave të apelit si anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe 1 (një) prokurori si anëtar në Këshillin Drejtues të Magjistraturës.

Lista emërore e prokurorëve e hartuar paraprakisht nga Sektori i Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme është me numër rendor 231 (dyqindetridhjetënjë).

Në listë janë regjistruar të gjithë magjistratët e emëruar si prokurorë dhe që kryejnë funksionet e prokurorit, të gjithë prokurorët që kanë statusin e magjistratit dhe që shërbejnë për një kohë të caktuar në strukturat e tjera shtetërore, si dhe të gjithë prokurorët që janë me leje sipas ligjit, me kusht që, në ditën e votimit nuk kanë mbushur moshën e pensionit. Prokurorët e pezulluar gjatë procesit të rivlerësimit, të pezulluar nga KLP apo me vendim gjyqësor, nuk janë pjesë e kësaj mbledhje.

Nga lista emërore e nënshkruar vërtetohet se morën pjesë në mbledhje 200 (dyqindë) prokurorë të të gjitha niveleve.

Votimi nisi në orën 11.00 pasi Prokurori i Përgjithshëm, verifikoi për ekzistencën e kuorumit të nevojshëm, i përcaktuar nga neni 112/2 i ligjit nr.115/2016 dhe përfundoi në orën 12.12.

**I.** U hap kutia e votimit, për kandidatin për anëtarin në Këshillin e Lartë të Prokurorisë duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga administrata ishin përgatitur 230 fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 200 (dyqindë). Ngelen 30 fletë votimi të papërdorura.

Nga numri total i votave, rezultoi se 196 (njëqindëenentëdhjetëegjashtë) fletë votimi janë të vlefshme dhe 4 (katër) fletë votimi janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- Znj. Ledina Riza **115 vota;**
- Z. Etien Kapo, **83 vota;**

Në përputhje me nenin 115/5 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallet fitues, për prokurorit e Apelit kandidati **znj.Ledina Riza.**

**II.** U hap kutia e votimit, për kandidatin anëtar në Këshillin Drejtues të Magjistraturës duke verifikuar kodet e administruara nga komisioni i votimit dhe rezultoi se përputhen me kodet e vendosura para fillimit të votimit.

Nga administrata ishin përgatitur **230** fletë votimi.

Nga numërimi rezultoi se numri total i votave të hedhura në kuti është 200 (dyqind). Ngelen 30 fletë votimi të papërdorura.

Nga numri total i votave, rezultoi se 196 (njëqindëenentëdhjetëegjashtë) fletë votimi janë të vlefshme dhe 4 (katër) fletë votimi janë të pavlefshme.

Nga numërimi i votave të vlefshme, të lexuara e shfaqura për gjithë të pranishmit, rezulton të jetë votuar për kandidatët, si vijon:

- Znj Elona Alvaro **20 vota;**
- Z. Arqilea Koça, **76 vota;**
- Z. Albert Kuliçi **100 vota;**

Në përputhje me nenin 247, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, shpallet fitues, si anëtar në Këshillin Drejtues të Magjistraturës kandidati z. Albert Kuliçi.

Proceverbali mbahet në 2 (dy) kopje, u lexua e u gjet i rregullt dhe firmoset pa vërejtje nga Komisioni i Votimit.


Procesverbali, vendimi dhe gjithë materialet e votimit i dorëzohen Prokurorit të Përgjithshëm, sot në datë 25.10.2022.

Procesverbali mbyllet në orën 13.15.

### **KOMISIONI I VOTIMIT**

**KRYETAR**

**ALMA MUÇA**



**ANËTAR**

**THOMA JANO**



**ANËTAR**

**ALFRED PROGONATI**

